

TURGUT ÖZAL

BULETINI



PËRMBAJTJA

Videoklipi “Rroftë Shqipëria”

Viti i ri shkollor 2018-2019

Klubi i Medias

Drejtorë
Gleris Bekteshi
Ahmet Ercanli

Kryeredaktore
Imelda Prençe

Redaktorë
Elda Rrustemi
Erjona Saqe
Enkelejda Velo
Ardiana Sallaku

Nxënës
Rei Korkuti
Nikol Dalipi
Meri Berisha
Ergita Zenelhasanaj
Stelakea Mërtiri
Sidrit Hoxha
Tea Çerenishta
Engjëllushe Basha
Vivien Shkodra
Alenis Ivanaj
Hera Hadëri
Enia Xhaferraj
Suada Xholi
Sidrit Rrustemi
Kiara Olldashi

Fotograf
Lulëzim Marra

Dizajn
Dorjan Pitani

**Muaji i Letërsisë, i Arteve dhe i
Historisë**

Vizita në Institucione

ADRESA
Rruga “Bernardin Palja”
Ndërtesa 15, Hyrja 1
Njësia Bashkiake Nr.6
Tiranë – Shqipëri

TEL: +355 42 486-666
FAX: +355 42 486-666
info@turgutozal.edu.al

TURGUT ÖZAL

19

TIRANA

Konkurse dhe Olimpiada

Shëtitje dhe veprimtari të tjera zbavitëse

Mësojmë përmes praktikës

Aktivitete sportive

Temat e kopshtit

Për reklamimin e produkteve dhe shërbimeve tuaja në buletin tonë, kontaktoni nëpërmjet postës elektronike.

Videoklipi “Rroftë Shqipëria”

Videoklipi “Rroftë Shqipëria” jehon fuqishëm, duke uruar shqiptarët kudo ku ndodhen dhe duke përcjellë emocione e vlera në respekt të kombit, flamurit e krenarisë kombëtare. Shqipja krenare çon peshë zemrat e shqiptarëve dhe amanetin e brezave për të fluturuar e lirë me Flamurin e Atdheut në zemër. Fluturimi i saj në malet shqiptare jehon si melodi e shekujve, se mbi gjithçka është Shqipëria.





Viti i ri shkollor 2018-2019



Mes buzëqeshjeve, gëzimit, përqaftimeve e buqetave me lule erdhi ky fillimviti shkollor edhe në Kolegjin "Turgut Özal". Oborret, korridoret, klasat dhe ambientet e ndryshme të shkollës u gjallëruan nga zërat e fëmijëve, të cilët përshëndeteshin plot mall me njëri-tjetrin dhe mësuesit. Në këtë vit të ri shkollor, në bankat e shkollës "Turgut Özal" janë ulur rreth 1642 nxënës, nga klasa e 1-rë deri në klasën e 9-të. Janë këta nxënës, të cilët na bëjnë përherë krenarë me rezultatet dhe arritjet e tyre.

Fëmijët e klasave të para në Kolegjin “Turgut Özal”

Në Kolegjin “Turgut Özal”, dita e parë e shkollës për fëmijët e klasave të para ka sjellë urime dhe emocione të shumta për 168 fëmijë, të cilët janë ulur në bankat e shkollës sonë. Klasat dhe mjediset e ndryshme të shkollës janë zbukuruar për t’i pritur vogëlushët mes ngjyrave, buzëqeshjeve dhe urimeve. Emocione viheshin re edhe te prindërit dhe te të afërmit e fëmijëve, që nëpërmjet fotografive të shumta, i fiksonin me kënaqësi këto çaste të paharrueshme për fëmijët e tyre. U urojmë suksese dhe një vit sa më të mbarë shkollor mësuesve dhe nxënësve të klasave të para!



Muaji i Letërsisë, i Arteve dhe i Historisë



Muaji i Letërsisë, i Arteve dhe i Historisë

Muajt tetor-nëntor sjellin gjithmonë fillimin e aktiviteteve letraro-artistike dhe historike në shkollën tonë.

Konkursi i Artit dhe Letërsisë është një nga aktivitetet kryesore të këtij muaji, së bashku me aktivitetet e tjera kulturore dhe edukative.

Konkurset e Fjalës Artistike, Kompozicionit, Këngës dhe Artit figurativ janë nga veprimtaritë më të dashura për nxënësit. Nxënësit përmes projekteve letrare dhe historike sjellin dhe vlerësojnë pasurinë shpirtërore e historike të popullit tonë.

Konkursi i Interpretimit



Konkursi i Kompozicionit

Përmes emocioneve, fantazisë dhe kreativitetit, u zhvilluan dhe Konkursi i Kompozicionit, ku nxënësit pjesëmarrës evidentojnë krijimtarinë dhe shprehin talentin përmes të shkruarit. Temat ishin të larmishme, një subjekt i përbashkët ishte tema mbi arsimin dhe dijen, por nuk munguan dhe tema që lidhen me koncepte të tjera kyçe të jetës dhe prekin çdo individ në komunitetin tonë.



Konkursi i Këngës




Muzika është gjuha e shpirtit përmes tingujve, shprehja më e bukur e emocioneve tona. Të gjithë kur dëgjojmë muzikë qetësohemi dhe futemi në një botë të qetë, ku gjithçka është e bukur. Ishin këto ndjenjat që përcollën tek anëtarët e jurisë nxënësit finalistë të Konkursit të Këngës. Me zërat e tyre të ëmbël, të fuqishëm e melodioz ata sollën në skenë këngë nga më të bukurat dhe që kanë mbetur e jetojnë te secili prej nesh.



Konkursi i Instrumenteve muzikore



Më datë 18 dhjetor u zhvillua Konkursi i Instrumentistëve. Morën pjesë rreth njëzet nxënës, të cilët kanë pasion pianon, kitarën e violinën. Meloditë që vinin nga instrumentet ishin përrallore dhe fëmijët akoma më të mahnitshëm në interpretimin e tyre virtuoz. Ata sollën në skenën e sallës së koncerteve veprat e kompozitorëve më të shquar klasikë e modernë. Në juri ishte dhe kompozitori i famshëm Genti Lako, i cili nuk mund të mos mrekullohej nga dashuria dhe pasioni, me të cilët fëmijët u binin veglave të tyre muzikore. Në fund të konkursit u shpërndanë çmime dhe certifikata.



Konkursi i Artit Pamor



Në Konkursin e Artit Pamor nxënësit që morën pjesë, patën mundësinë për të shprehur ndjenjat e talentin e tyre nëpërmjet një gjuhe kaq të bukur siç është arti i ngjyrave. Temat e përzgjedhura ishin mjaft të njohura dhe të realizueshme nga ana e fëmijëve, duke përfshirë këtu “Natyra e Qetë”, “Mbrojtja e Mjedisit”, “Përmes ëndrrës”, “Bullizmi” dhe temat e lira, të cilat krijojnë hapësirën e duhur që nxënësi të shprehë imagjinatën, duke ndërthurur e përcjellë elementë edukativë në formën e vijave, ngjyrave dhe figurave.

Për Ty Atdhe



"Shqipëri o vendi im, mbushur dritë krenari, të kam nënë e më ke bir' nëna ime Shqipëri!"

Atmosfera e Festave të Nëntorit jehoi në ambientet e Kolegjit "Turgut Özal" përmes emocioneve që përçollën koncertet e organizuara me rastin e këtyre festave.

Për këtë vend vargjet më të bukura janë shkruar, tingujt më të bukur janë kënduar me fuqinë e shpirtit, sepse ky vend i vogël, mbart një histori të madhe.

Poezitë dhe këngët kushtuar Flamurit e Atdheut, vallet plot ngjyra e të interpretuara me aq hijeshi e elegancë, sajë talentit dhe përkushtimit të nxënësve tanë, emocionuan të gjithë të pranishmit

Në Panairin e Librit me nxënësit e apasionuar me librin dhe leximin



Panairi i Librit "Tirana 2018" u vizitua edhe nga nxënësit lexues më të rregullt në orarin e leximit, që çdo mëngjes vijon në shkollën "Turgut Özal".

Panairi i librit pritet me padurim dhe kënaqësi nga nxënësit tanë. Në cilëndo stendë shihje nxënësit, të cilët me shumë dëshirë e kënaqësi bisedonin vetëm për librat, një bisedë kaq e dashur dhe me kaq shumë vlera. Leximi i librave jashtëshkollorë dhe edukimi i nxënësve me dëshirën për librin dhe leximin, janë po aq të rëndësishme në shkollën tonë sa dhe mësimet.

Nxënësit e klasave të 6-ta në Panairin e Librit

Ishin nxënësit e klasave të 6-ta, të cilët e vizituan këtë panair që në ditën e parë të tij e në vazhdim, si një meritë për "Projektet më të bukura për Muajin e Artit dhe të Letërsisë".

Nxënësit të entuziazmuar i shfletonin faqet e librave plot dashuri dhe gjithashtu nuk i shpëtuan dot tundimit për të blerë disa syresh, të autorëve të njohur e jo vetëm, për t'i bërë pjesë të bibliotekës së tyre të vogël.



Aktivitetet e Klubit Shpresa

Seminari i parë i Klubit Shpresa për vitin shkollor 2018-2019



Në seminarin e parë të Klubit Shpresa morën pjesë përfaqësuesit përkatës për secilin paralel dhe secilën klasë. Nxënësit u njohën me objektivat e synuara për këtë vit, ndër të cilat përmenden ndihmat e planifikuara në 2 shkolla dhe kopshte publike, në Spitalin Pediatrik, në Shoqatën e Jetimëve, në Shoqatën e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara, disa aktivitete të planifikuara me Qendrën DAWN SYNDROME ALBANIA, Foodbank Albania dhe disa aktivitete për "Fundjavë Ndryshe".

Klasat e 7-ta në Panairin Ushqimor

Nxënësit e klasave të shtata çelën për këtë vit Panairin Ushqimor, këtë aktivitet kaq të rëndësishëm të Klubit Shpresa. Mes një atmosfere mjaft mikpritëse dhe aromëmirë, të krijuar në sallën e panairove, nxënësit si bletë punëtore, rregulluan tavolinat me ushqime, të cilave ishte vështirë t'u rezistojë. Ëmbëlsirat dhe gatimet e shumëllojshme që këta nxënës kishin ekspozuar nëpër tavolina, tregonin për seriozitetin me të cilin nxënësit e shohin këtë aktivitet bamirës. Ata janë të lumtur që mund të ndihmojnë dhe të sjellin sadopak gëzim, aty ku mungon.



Klasat e 6-ta në Panairin Ushqimor

Panairi Ushqimor i klasave të gjashta tregoi sërish përkushtimin maksimal të nxënësve tanë për këtë aktivitet bamirës. Me një organizim si prej të rriturish, shpirtin e garës dhe, mbi të gjitha, dëshirën për të realizuar sa më mirë qëllimin human të këtij aktiviteti, fëmijët si rrallëherë treguan aftësitë e tyre në menaxhim dhe komunikim. Nuk munguan as reklamat dhe "ofertat" gjatë këtij aktiviteti, i cili është po aq edhe zbavitës për fëmijët, pasi iu duket vetja të rritur për të marrë përgjegjësi.



Klasat e 8-ta në Panairin Ushqimor



Mes muzikës dhe ambientit të hareshëm, Panairi Ushqimor vijoi me pjesëmarrjen e klasave të teta. Secila klasë përdorte mënyra nga më të ndryshmet, për të tërhequr vëmendjen e blerësve të produktet e tyre. Në çdo tavolinë mbizotëronin ëmbëlsirat, që u pëlqyen shumë, sidomos nga fëmijët, por edhe tek mesazhi shumë i rëndësishëm që ky panair përcjell.

Ëmbëlsi në Panairin Ushqimor

Ëmbëlsia dhe shija e Panairit Ushqimor gjatë kësaj jave ishte shumë e veçantë. Ishin nxënësit e shkollës fillore, të cilët me përkushtim dhe shumë dashuri reklamnin ushqimet e gatuar me aq dashuri nga mamat e gjyshet dhe bënin për vete çdo blerës.

Diku si flutura të bukura e diku si bletë punëtore, të veshur si mastershefa të vërtetë kuzhine, këta fëmijë gjallëruan ambientet e sallës së panairove.



Mbyllja më e bukur e Panairit Ushqimor

Ishin nxënësit më të vegjël të shkollës sonë, fëmijët e klasave të para dhe të kopshtit, ata që mbyllën Panairin Ushqimor. Salla e panairove ishte e mbushur me aromë shijesh të mrekullueshme të gatimeve tradicionale të zonave të ndryshme, por bukuria e vërtetë shihej në sytë dhe fytyrat gazmore të fëmijëve.

Fëmijët të lumtur dhe të ndihmuar nga mësueset reklamnin ushqimet e tyre të përgatitura me shumë dashuri. Një falenderim i veçantë shkon dhe për të gjithë prindërit, që dhanë kontributin e tyre për këtë çështje të rëndësishme dhe humane, për të edukuar të fëmijët ndjenjën e bukur të zemërgjerësisë.



Klubi Shpresa në shkollën “Androkli Kostallari”

Anëtarët e Klubit Shpresa, nxënësit e “Turgut Özal” të klasave të teta dorëzuan te shkolla “Androkli Kostallari” kartona, penela, tempera, telajo të madhësive të ndryshme, lapsa druri, lapustila dhe bojëra vaji për kompletimin e Dhomës së Artit si dhe të bibliotekës së shkollës “Androkli Kostallari”. Ndërsa për Klubin e Sportit dhuruan topa futboli, basketbolli, volejboli dhe rrjeta volejboli. U dhuruan dhe 400 libra për bibliotekën e shkollës dhe disa komplete librash për mësuesit e gjuhës angleze.



Klubi Shpresa në Shoqatën Kombëtare të Prindërve për Kujdesin e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara

Ishin nxënësit e klasave të 5-ta, anëtarë të Klubit Shpresa, të cilët organizuan një aktivitet bamirësie në Shoqatën Kombëtare të Prindërve për Kujdesin e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara. Në këtë aktivitet u shpërndanë 62 pako me ushqime për 62 familje në nevojë. Pakot e ushqimeve u përgatitën nga vetë nxënësit, anëtarë të Klubit Shpresa dhe u mundësuan nga fondet e mbledhura nga Panairi Ushqimor.



Klubi Shpresa në ndihmë të fëmijës me aftësi ndryshe

Klubi Shpresa në bashkëpunim me Qendrën DSA (DOWN SYNDROME ALBANIA) ndihmon fëmijën me aftësi ndryshe dhe familjen e tij.

Anëtarët e Klubit Shpresa dhe djem të klasave të nënta shkuan në shtëpinë e Bilbilit të vogël dhe i dhuruan krevatin së bashku me batanije, jastëkë, këllëfa jastëku dhe çarçafë, atij dhe gjyshes së tij. Montimi i krevatit dhe rregullimi i tij u bë nga vetë nxënësit e shkollës sonë, të cilët e kanë në zemër bamirësinë dhe ndihmën e njerëzve në nevojë.



Koncert bamirësie për fëmijën talasemik në Kolegjin “Turgut Özal”

Ambientet e Sallës së Koncerteve, të shkollës “Turgut Özal”, u bënë vendi i organizimit të Koncertit të Bamirësisë “Tingujt e jetës”, një koncert i organizuar nga një grup miqsh, studentë të vitit të dytë në Fakultetin e Mjekësisë, për të ndihmuar Shanikon e vogël, 6-vjeçaren që vuan nga talasemia dhe familjen e saj që jetonte në kushte të mjerueshme.

Gjatë koncertit familja Nela mori dhe një lajm tjetër të gëzuar nga drejtori i Kolegjit “Turgut Özal”. Për një vit Kolegji “Turgut Özal” dhe Klubi Shpresa, do të mbulojnë shpenzimet e transportit dhe mjekimit të Shanikos së vogël.



Aktivitet i Klubit Shpresa me rastin e Festave të Fundvitit



Të gjithë kundër urisë...

Në vijim të aktiviteteve të tij, Klubi Shpresa në bashkëpunim me Foodbank Albania organizoi me rastin e Festave të Fundvitit, aktivitetin për mbledhjen e ndihmave ushqimore për familjet në nevojë. 2 tonë e 121 kg ishte sasia e ushqimeve që u grumbulluan gjatë këtij aktiviteti. Paket me ushqime iu dhuruan nga Foodbank Albania, familjeve në nevojë, për të sjellë pranë tyre sadopak gëzim e buzëqeshje për Festat e Fundvitit.

Klasa e 6D dhuron ndihma për familjet në nevojë në Babrru e Paskuqan



Nxënësit e klasës së 6D, të shoqëruar nga mësuesja kujdestare dhe një punonjës social, vizituan dy familje në zonën e Babrrusë dhe të Paskuqanit, ku dhanë ndihma ushqimore dhe një shumë modeste parash, me qëllimin për të lehtësuar sadopak jetesën e tyre dhe për t'u sjellë sadopak gëzim në prag të festave të fundvitit. Varfëria që i kishte pllakosur ato familje ishte e thellë dhe e rëndë. Gjendja që panë, zgjoi tek nxënësit dëshirën për të marrë gjithnjë të tilla nisma.

Klasa e 6B në ndihmë të familjes në nevojë

“Në ndihmë të familjeve në nevojë në prag të Festave të Fundvitit”, ishte motoja, e cila frymëzoi nxënësit e klasës së 6B, të cilët së bashku me mësuesen e tyre kujdestare i erdhën në ndihmë një familjeje në gjendje të mjerueshme, e cila jeton në Institut të Kamzës. Nxënësit mblodhën ndihma monetare, por edhe veshje, ushqime e lodra të ndryshme dhe gjithashtu edhe një shumë prej 27000 lekësh të reja.



Me Klubin Shpresa në një Festë Fundviti të veçantë

Në një atmosferë tejet festive, mes lojërave të ndryshme zbavitëse, haresë, të qeshurave dhe gëzimit fëmënor, disa nga anëtarët e Klubit Shpresa dhe drejtues të tij u bënë pjesë e një feste të veçantë.

Ishte pikërisht Festa e Fundvitit e fëmijëve me Aftësi Ndryshe të Qendrës DSA, të cilëve Klubi Shpresa u mundësoi animatorin e festës dhe dhuratat e Vitit të Ri.



Vizita në Institucione

Klasa e 8E vizitë në Bunk'Art dhe në Kontrollin e Lartë të Shtetit



Klasa e 8E mori pjesë në një organizim jashtëshkollor, i cili filloi me vizitën në Bunk'Art, ku nxënësit njohën dhe eksploruan të shkuarën e zyrtë të vendit tonë gjatë kohës së diktaturës. Pas kësaj klasa e 8E vizitoi Kontrollin e Lartë të Shtetit, ku u mirëpritën dhe ku mësuan shumë rreth funksioneve të këtij institucioni.

Vizitë në Muzeun Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”

Klevi Murrizi, nxënës në klasën e 4G, i cili e pëlqen shumë lëndën e historisë, i ftoi të gjithë shokët dhe shoqet e tij në Muzeun Kombëtar “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”. Klevi dhe prindërit e tij kishin zgjedhur këtë vend dhe këtë mënyrë kaq simbolike dhe të veçantë për të festuar ditëlindjen e Klevit.



Nxënësit e klasave të 6-ta në Teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”



Nxënësit e klasave të 6-ta ndoqën shfaqjen me titull “Libraria e Magjepsur” në Teatrin Kombëtar Eksperimental “Kujtim Spahivogli”. Kjo pjesë flet për një vajzë që e ka emrin Deizi dhe që i adhuron librat.

Nxënësit e ndoqën shfaqjen me shumë interes e kënaqësi. Ata dolën nga kjo shfaqje me një mesazh shumë të qartë, i cili kishte si qëllim t’u tregonte se sa të rëndësishëm janë librat dhe se sa ata duhet të vlerësojnë çdo faqe e çdo personazh.

Nxënësit e klasave të teta në një seminar për BE-në

Më datë 14 dhjetor, nxënësit e klasave të teta zhvilluan një seminar, përmes të cilit thelluan njohuritë e tyre në lidhje me BE-në. Seminari u udhëhoq prej tre studenteve nga Universiteti Epoka. Me anë të një prezantimi mjaft argëtues, ato i angazhuan nxënësit duke i ftuar në skenë që të paraqisnin shtetet e anëtarësuar. Në këtë mënyrë ato i njohën nxënësit me historikun e BE-së që nga krijimi i Beneluksit më 1944 e deri tek anëtarësimi i Kroacisë në 2013. Përveç kësaj ato i njohën nxënësit me synimin e Shqipërisë për t'u bërë pjesë e familjes së Bashkimit European dhe me përparësitë e shumta që do të sjellë ky anëtarësim.



Vizitë në Institutin e Nxënësve që nuk Shikojnë “Ramazan Kabashi”



Nxënësit e klasës së 3F, gjatë orës së qytetarisë “Edukimi me vlera”, në bashkëpunim me Kryetaren e Këshillit të Prindërve, znj. Ilva Çuko, zhvilluan një orë edukative në mjediset e Institutit të Nxënësve që nuk Shikojnë. Krahas njohjes dhe familjarizimit me nxënësit e institutit, me alfabetin Braille dhe tekstet mësimore, nxënësit e shkollës sonë kishin përgatitur me shumë dashuri dhurata të ndryshme të shoqëruara me ëmbëlsira.

Nxënësit e klasës së 1A vizitë te OST-ja

Ditën e martë, nxënësit e klasës së 1A iu përgjigjën pozitivisht dhe me kënaqësinë më të madhe ftesës së prindërve të shokut të tyre të klasës, Kroit, për të vizituar ambientet e punës së tyre. Prezenca në këto mjedise, u mundësoi atyre vëzhgimin e të gjithë hapave të shpërndarjes së energjisë deri në shtëpi. Fëmijët panë nga afër se si energjia elektrike përcillet nga OST-ja në banesë, në shkollë e në çdo mjedis tjetër që funksionon me energji.



Konkurse dhe Olimpiada

Oxford Placement Test

Oxford Placement Test ose OPT, siç njihet nga nxënësit, është një test i standardizuar nga Oxford University Press dhe i mundësuar nga shkolla jonë, i cili teston njohuritë e nxënësve në gjuhën angleze. Ky testim zhvillohet për nxënësit nga klasat e 3-ta deri në klasat e 9-ta, në fillim dhe në fund të vitit shkollor, pra dy herë në vit. Nxënësit vlerësohen për njohuritë e tyre në dëgjim e në përdorimin e drejtë të gjuhës dhe në fund marrin një certifikatë, e cila pasqyron nivelin e tyre të anglishtes.



Testi përzgjedhës për Olimpiadën Cogito

Çdo vit në shkollën tonë organizohet Olimpiada Cogito. Në testimin përzgjedhës morën pjesë nxënësit më të mirë, nga klasa e 6-të e deri në të 9-të, në lëndë të ndryshme, si : matematikë, fizikë, biologji, kimi dhe informatikë. Nga ky testim do të përzgjidhen një grup nxënësish, të cilët gjatë vitit do të punojnë me mësuesit përkatës të lëndës, që të bëjnë të mundur arritjen e rezultateve të larta në provimin përfundimtar.



Prezantim për Olimpiadën Owlypia

Në prag të konkursit global "Owlypia" disa nga nxënësit e klasave të nënta, pjesëmarrës vitin e kaluar në konkursin internacional "Intellectuals' challenge", zhvilluan seminare në të gjitha klasat e paralelet e shkollës për të njohur shokët me këtë sfidë njohurish. Ata ndanë eksperiencat e tyre, duke dhënë këshillat dhe informacionet e nevojshme për bashkëmoshatarët e tyre.



Konkursi i Owlypias



Në nëntor, në ambientet e Kolegjit "Turgut Özal", u zhvillua Konkursi i Owlypias, konkurs global për grup-moshat 11-14 vjeç dhe 15-18 vjeç. Në këtë konkurs shkolla jonë u përfaqësua me 107 nxënës, nga klasat e 6-ta e deri tek të 9-tat.

Tema e këtij viti ishte "Kreativiteti përtej kufijve".

Për më të mirët dhe fituesit ka çmime deri në £12 950, ku përfshihen ulje speciale për Sfidat Globale TIC në Davos, Sidney, Cambridge dhe Harvard.

Rezultatet që arritën nxënësit e shkollës sonë në këtë konkurs, në të cilin morën pjesë rreth 1300 nxënës nga 31 vende të ndryshme, janë si më poshtë:

Medalje ari: 30 nxënës

Medalje argjendi: 26 nxënës

Medalje bronzi: 25 nxënës

Certifikatë nderi: 13 nxënës

Certifikatë pjesëmarrjeje: 13 nxënës

Krenohemi me arritjet e nxënësve tanë dhe iu urojmë shumë suksese edhe në të tjera sfida e konkurse!

Ceremonia e ndarjes së çmimeve të Konkursit Owlypia



U zhvillua në një atmosferë tejet entuziaste dhe plot emocione në Sallën e Konferencave të Kolegjit “Turgut Özal”, ndarja e çmimeve të Konkursit Owlypia.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin nxënësit pjesëmarrës në konkurs dhe prindërit e tyre, të cilët u ndjenë shumë krenarë për arritjet e fëmijëve të tyre në këtë konkurs ndërkombëtar.

47 Medalje ari, 36 Medalje argjendi, 28 Medalje bronzi, 15 Certifikata nderi ishin çmimet që u fituan nga nxënësit tanë të shkollës 9-vjeçare dhe të mesme. Ishin këto medalje e vende fituese, të cilat bënë që Shqipëria të renditej e para për nga medaljet e fituara në këtë konkurs.

Ceremonia e ndarjes së çmimeve në Finalen e Madhe midis Kolegjeve



Kjo iniciativë e shkëlqyer që është bërë traditë tashmë në shkollat tona, i ka fillesat pikërisht në investimet që ne bëjmë si shkollë për talentet dhe brezin e ri. Dhe gjithashtu, fakti që nxënësit e talentuar duhen mbështetur, duke u motivuar në mënyrat e duhura me të gjitha mundësitë dhe potencialet ndihmëse që mund t'u ofrojë shkolla e më gjerë.

Fushat e konkurrimit që përfshihen në këto konkurse janë: Arti Pamor, Kënga, Interpretimi dhe Krijimi.

Në juri ishin sërish me emra nga më të njohurit në fushën e këngës dhe artit shqiptar.

Në Konkursin e Interpretimit juria përbëhej nga aktorët: Ndriçim Xhepa - Nderi i Kombit, Rajmonda Bulku – Artiste e Merituar dhe Mimoza Mevlani – Mjeshtre e Madhe Pune.

Në Konkursin e Këngës juria përbëhej nga këngëtaret: Irma Libohova-Mjeshtre e Madhe Pune, Blerina Braka dhe Orgesa Zaimi.

Ndërsa juria e Konkursit të Krijimit dhe e Konkursit të Artit Pamor përbëhej nga mësuesit e shkollave tona.



“Rritem me vlerat e vendit tim!”

ZAL COLLEGE



Shëtitje dhe veprimtari të tjera zbavitëse

***Për herë të parë në
bibliotekën e shkollës...***



Nxënësit e klasave të para, të shoqëruar nga mësuesja kujdestare dhe ajo ndihmëse, kanë vizituar bibliotekën e shkollës gjatë orarit të orës së leximit. Kjo shkëputje e shkurtër nga përditshmëria mësimore i njohu ata me një ambient të shkollës, që akoma nuk e njihnin, por që e pëlqyen sapo e gjetën veten brenda tij.

Aty ata përzgjedhën libra me kopertina tërheqëse, dhe shfletuan faqet e tyre plot kuriozitet. Ishte një eksperiencë që u zgjoi menjëherë interesin dhe dëshirën për të lexuar.

Ekskursion në Pezë

Nxënësit e klasave të para zhvilluan ekskursionin me temë "Vjeshta" në Pezë. Qëllimi i tij ishte vërtetimi i ndryshimeve që sjell stina e vjeshtës në natyrë, por edhe argëtimi. Sapo arritën në Pezë nxënësit filuan të zbaviteshin duke luajtur lojëra të ndryshme, si: tërheqje me litar, futboll, gara me vrapime e lojëra me stafeta. Në fytyrat e tyre shihej gëzimi e lumturia tek luanin e bisedonin me njëri-tjetrin.



Mes ngjyrave e haresë në Ditën e balonave

Dita e balonave, u festua në mënyrë të veçantë, sidomos nga fëmijët e klasave të para. Si rrallëherë oborri i shkollës ishte mbushur me ngjyra dhe gumëzhinte nga zërat e nxënësve që vraponin duke ngritur balonat në qiell. I mbuluar me balonat ngjyra-ngjyra, ku njëra fluturonte më lart se tjetra, oborri i shkollës dukej më i bukur se çdo ditë tjetër.



Në Qytetin e Legjendës me nxënësit e klasave të 5-ta



Përt'u njohur më mirë me historinë, mitet dhe legjendat tona, nxënësit e klasave të 5-ta zhvilluan një ekskursion në Shkodër. Me të arritur në Shkodër, ndalesën e parë e bënë në kalanë e Rozafës. Hijerëndë, e bukur dhe bujare, si një zonjë e vërtetë shtëpie, kalaja hapi portat e saj për nxënësit. E ndërtuar në rrëzë të qytetit të Shkodrës, është ajo e para që i uron mirëseardhjen dhe mirëpret çdo vizitor në qytet. Një nga vendet më interesante e mbresëlënëse të kalasë ishte vendi në të cilin, sipas legjendës, është murosur Rozafa. Nxënësit u argëtuan në mjediset e saj dhe shijuan pamjen e bukur të natyrës dhe të lumit Buna.

Një paradite në Pezë me klasat e treta

Një shprehje e dëgjuar popullore thotë se shpirti i fëmijës është tek loja. Prandaj dhe çdo kohë argëtimi për ta është pjesa më e bukur e ditës. Dhe s'ka më mirë se sa të argëtohesh në ajrin e pastër dhe natyrën tërheqëse të fshatit mikpritës të Pezës. Për fëmijët e klasave të treta kjo paradite kaloi mes zbavitjeve të lojërave me litar, ndeshjeve të futbollit, lojës kukafshehthi dhe shumë të tjerave.



Një fundjavë e këndshme në Llogara me vajzat e klasave të 7-ta, të 8-ta e të 9-ta



Një fundjavë e këndshme për vajzat e klasave të 7-ta, të 8-ta dhe të 9-ta mbi kurorën e gjelbër të drurëve halorë në Llogara. Gjatë rrugës pati ndalesa për të vizituar vende të veçanta si Laguna e Nartës, Pedonalja në Vlorë dhe Qafa e Llogorasë. Pushueset tona e sfiduan lodhjen dhe kaluan një natë plot argëtim mes lojërave të ndryshme, frekuentimit të pishinës dhe bisedave të ëmbla në rrethin e tyre shoqëror.

Djemtë e klasave të 7-ta ekskursion në Llogara

Djemtë e klasave të 7-ta organizuan një ekskursion në Parkun Kombëtar të Llogorasë. Gjatë rrugës nxënësit ndaluan për të vizituar vende të tilla si Vlorë apo Laguna e Nartës, për t'u ndalur në Llogara në "Pishën Flamur". Nxënësit ia kaluan shumë bukur. Ishte vërtet një udhëtim që do t'u mbetet për një kohë të gjatë në mendje.



Një ditë e bukur me njëri-tjetrin në Pezë



Ajri i pastër, ndjesia e lirisë, gjelbërimi në ikje i Parkut të Pezës dhe të qeshurat e çiltra që i shoqëronin gjithandej, ishin pjesë e ekskursionit të nxënësve të klasave të dyta. E veçantë ishte dhe ekspedita në mal. Nxënësit bashkë me mësuesit u ngjitën në mal me emocione dhe me paksa frikë nga pas. Nuk mund të mungonin as ngritja e balonave, lojërat me top, tërheqje litari, gara shpejtësie dhe kalime pengesash, të cilat shoqëroheshin dhe me shpirtin e garës dhe dëshirën për fitore.

Një vizitë në Berat me klasat e 6-ta

Një ditë e bukur për nxënësit e klasave të 6-ta e kaluar në qytet-muzeun e Shqipërisë, Beratin. Pas shëtitjes nëpër rrugët e pjerrëta me kalldrëm nxënësit u ngjitën në kala, nga ku vështruan me kënaqësi lagjen brenda mureve të saj, e cila është ende e banuar. Ajri i pastër dhe gjelbërimi i pishave, i shoqëruar me aromën dehëse të luleve të shumëllojshme të kënaqnin pa masë. Mos të lëmë pa përmendur fotot e shumta që iu bënë Lumit Osum nga Ura madhështore e Goricës.



Nxënësit e klasës së 9A dhe 9H në Durrës

Nxënësit e klasës së 9A dhe të 9H, kanë zhvilluar një ekskursion në qytetin bregdetar të Durrësit. Ky ekskursion erdhi në sajë të impenjimit të tyre maksimal në Panairin Ushqimor. Bukuria e këtij qyteti duket se përfshiu edhe nxënësit mes saj dhe orët kaluan pa u ndier. Përgjatë rrugës së kthimit, fëmijëve u mbeti në mendje fladi bregdetar, së bashku me shkumën e bardhë të valëve të detit apo pulëbardhat, këta shpendë, të cilët i pritën më së miri "në shtëpinë e tyre" vizitorët kryeqytetas.



Vizitë në Kinema Cineplex me klasat e 1-ra



Nxënësit e klasave të para realizuan një ditë mësimore zbavitëse në një nga mjediset më të preferuara prej tyre, në kinema.

Filmi i pëzgjedhur për t'u ndjekur në mjediset e Cineplex ishte një nga filmat më të parapëlqyer nga fëmijët, si dhe më i ndjekuri prej tyre "The Grinch". Vizita e nxënësve të klasave të 1-ra në kinemanë e Teg-ut, u shoqërua me argëtim dhe zbavitje pafund.

Klasat e treta në kinema

Klasat e 3-ta u organizuan në një ekskursion, objektivi i të cilit ishte argëtimi në atmosferën e Kinemasë Cineplex. Filmi "The Grinch" solli historinë e një krijese të çuditshme të quajtur Grinç, qenit të tij besnik Maks dhe jetës së vetmuar që ai bën në malin Krumpet. Filmi s'ishte tjetër veçse një mesazh për forcimin e lidhjeve familjare e shoqërore gjatë ditëve të gëzueshme dhe përçonte mendimin se ndjenja e vetmisë shërohet më shpejt në shoqërinë e atyre që të vlerësojnë për atë që je.



Shkolla dimërore në Londër



Udhëtimi i radhës i nxënësve tanë ishte drejt Anglisë. Megjithëse dimër, koha ishte e mirë dhe kështu me diell i mirëpriti dhe qyteti i bukur i Londrës. Pas akomodimit në hotel mezi po prisnin aventurat që ky udhëtim u kish rezervuar. Ashtu siç ishte programuar, u nisën që në mëngjes drejt Winter Wonderland Park. Kaluan 3 orë të mrekullueshme duke provuar edhe lodrat më të vështira dhe pas drekës përshkruan Hyde Park, parkun e madh që rrethon Buckingham Palace. Pallati i mbretëreshës Elizabetë u shfaq para tyre me madhështinë e tij sa historike, aq edhe arkitekturore. Në kthim s'mund të ishin indiferentë ndaj kafshëve të ndryshme të parkut, ndaj dhe gjatë gjithë kohës bënë fotografi të panumërta. Të nesërmen hipën tek London Eye dhe vazhduan udhëtimin me anije përgjatë Thames River Cruise. Pas një dreke të këndshme vazhduan argëtimet në Sea Life Aquarium dhe Shrek's Adventure, ku kënaqësia e fëmijëve ishte e pafund. Ditën tjetër nxënësit vijuan me mësimet e anglishtes, me vizitën tek Arsenal Stadium dhe turi i radhës vazhdoi drejt Oxford City. Ndërsa në ditët në vazhdim, me ndihmën e një guide vizituan Qytetin e Vjetër, si dhe Natural History Museum, Science Museum dhe Madame Tussauds Wax Museum, më pas vendet e xhirimit të filmave "Harry Potter" e "Lord of Rings" dhe rrugëtimi u përmbyll me magjinë e kinemasë, ku shijuan filmin "Bumblebee".



Mësojmë përmes praktikës

Në Klubin e Robotikës

Klubi i Robotikës mbetet ndër më të preferuarit për nxënësit e shkollës sonë. Gjatë këtij viti akademik me këtë klub do të zhvillohen disa aktivitete. Fëmijët do të prezantohen me pajisjen Microbit dhe do të angazhohen në programimin e saj. Gjithashtu, si edhe vitin e kaluar, tematikë e klubit vazhdon të jetë programimi i lojërave të shumta në programin Scratch dhe ushtrimet zbavitëse e kreative me të.



Klasa e 1F mëson si mbillet një pemë



Të jetojmë në një mjedis të shëndetshëm dhe ta bëjmë vetë një mjedis të tillë.

Në ditët e sotme, kur ndotja e ajrit është një problem kudo nëpër botë, mënyra më e mirë e pastrimit të ajrit është gjelbërimi i mjedisit dhe mbjellja e pemëve. Në lidhje me këtë, nxënësit e klasës së 1F zhvilluan një orë edukative në oborrin e shkollës, ku mësuan se si të mbillnin një pemë me ndihmën e mësueses. Ata mësuan hapat e procesit të mbjelljes, që nga hapja e gropës, tek vendosja me kujdes e fidanit, e deri tek ujitja e tij pas mbjelljes.

Nxënësit e klasës së 5E mësime të hapur me temë kursimin



Të kursesh do të thotë të administrosh me cilësi maksimale të ardhurat e tua.

Ishte ky qëllimi i aktivitetit që nxënësit e klasës së 5E zhvilluan me zonjën Elona Borini. Me profesionin e saj si bankiere, ajo u shpjegoi nxënësve mënyra të ndryshme se si të kursenin. Nxënësit kuptuan se si ta bënin këtë në mënyrë afatshkurtër dhe afatgjatë.

Një orë ndryshe në lëndën e qytetarisë

Klasa e 3D zhvilloi një orë qytetarie në mensën e shkollës. Meqenëse tema mësimore e radhës titullohej "Ne kemi përvoja të ndryshme" dhe mes të tjerash fliste edhe rreth dallimeve kulturore mes qyteteve brenda një vendi, detyra e shtëpisë për nxënësit ishte gatimi bashkë me prindërit i një ëmbëlsire tradicionale të krahinës nga ata vijnë. Bashkë me mësuesen fëmijët diskutuan dhe dhanë mendime rreth këtyre gatimeve dhe rreth ndryshimeve në mënyrën e jetesës të disa trevave shqiptare.



Mësojmë nga gjyshërit tanë

Një temë mësimore në lëndën e gjuhës shqipe, që flet për lidhjen e ngushtë mes gjyshërve dhe fëmijëve, ishte pikënisja e organizimit të një ore mësimore mjaft interesante, ku të ftuar ishin gjyshërit e disa prej nxënësve të klasës së 3F. Si fëmijët, ashtu edhe gjyshërit sollën në klasë histori personale dhe situata të përjetuara përgjatë viteve në marrëdhënien gjysh-fëmijë, të cilat u pëlqyen shumë dhe u duartrokitën.



Nxënësit e së 4B në lëndën e qytetarisë



Forcojmë frymën e mirëkuptimit dhe të bashkëpunimit me njëri-tjetrin

“Si të jemi një qytetar i mirë”, ishte aktiviteti i radhës në lëndën e edukatës shoqërore, ku nxënësit e klasës së 4B, me udhëzimet nga mësuesja kujdestare, janë ndarë në katër grupe dhe kanë punuar mbi këtë temë. Secili grup kishte temën e vet, të gjitha temat ishin tema sociale dhe me karakter edukativ. Nxënësit punuan me zell dhe bënë postera me vizatime dhe mesazhe për tolerancën, barazinë, të drejtat e fëmijëve dhe përgjegjësitë.

Të lexojmë bukur e pa gabime



Çdo vit në muajin tetor nxënësit e klasave të dyta bëjnë testin e leximit bukur e pa gabime. Ky test ka qëllim që të shihet ecuria e leximit të nxënësi që sapo ka mbaruar klasën e parë dhe ka hyrë në klasën e dytë. Nxënësit i jepet një tekst jashtëshkollor dhe për një minutë ai e lexon. Nxënësit që nuk arrijnë nivelin e të lexuarit, udhëzohen se si mund ta përmirësojnë leximin e tyre në shtëpi dhe në orën e leximit në klasë.


Riciklo edhe ti!

Ndotja e vazhdueshme që po i bëhet tokës po shkakton një sërë pasojash negative, të cilat vihen re edhe më shumë me kalimin e viteve. Ricklimi është një nga mënyrat më bazike për të ndihmuar në pastrimin e mjedisit. Klasat e pesta dhanë kontributin e tyre në mjedis nëpërmjet riciklimit dhe u bënë një shembull i mirë për të gjithë ne. Nxënësit përdorën objekte të përditshme, si shishet plastike apo roletat e letrave higjienike. Duke vënë në punë imagjinatën e tyre, ata krijuan punime dore shumë të veçanta me përdorimin e bojërave dhe materialeve të tjera për t'i zbukuruar.



Biblioteka online 'myON'

Kolegji "Turgut Özal" në bashkëpunim me bibliotekën online 'myON' ka pajisur të gjithë nxënësit, duke filluar nga nxënësit e klasës së tretë e deri në klasën e nëntë, me një adresë përmes së cilës ata mund të lexojnë libra online. Biblioteka përmban mbi 5050 tituj dhe libra të llojeve të ndryshëm. Secili nxënës ka adresën dhe fjalëkalimin e tij. Gjatë ditëve të shkollës nxënësit mund t'i lexojnë librat në orën e leximit, duke shkuar tek iPad room ose në laboratorët e kompjuterave. Niveli i lexueshmërisë (lexile level) është i matshëm, pasi për çdo javë sistemi gjeneron një raport përsa i përket faqeve të lexuara, kohës së shpenzuar në bibliotekë dhe nëse niveli i lexueshmërisë është rritur apo jo. Gjithashtu për çdo libër ka quizë, përmes të cilëve çdo nxënës mat kuptueshmërinë ndaj librit të lexuar.



Klasa e 5E në lëndën e qytetarisë



"Të bashkuar në diversitet" ishte një nga temat që nxënësit e klasës së 5E e zhvilluan me projekte në grup dhe me diskutime të shumta. Secili prej nxënësve solli në klasë grupin, komunitetin ku bën pjesë, këndvështrimet, përvoja, stile jete dhe kultura të ndryshme. Nxënësit u shprehën që kanë nevojë për njëri-tjetrin dhe duke çmuar diversitetin mes tyre ndihmojnë, përfitojnë në mënyrë të ndërsjelltë. Projekte dhe punë të bëra në grup u përfaqësuan mjaft suksesshëm dhe më pas u afishuan në këndin e klasës.


Dita Kombëtare kundër Bullizmit



Dita Kombëtare kundër Bullizmit u organizua duke përfshirë nxënës, mësues, prindërdheanëtarëtetjetëkomunitetit. Mesazhe ndërgjegjëse u dhanë jo vetëm në mjediset e shkollës, por gjithashtu dhe në një organizim me pesë shkolla të tjera të Tiranës pranë hotel “Sheraton”. Kjo ditë u shoqërua me ekspozitën me piktura e punime të nxënësve dhe video-mesazhe realizuar nga mësuesit dhe nxënësit e shkollës me synimin e një thirrjeje ndaj gjithë atyre që ushtrojnë bullizëm, duke theksuar rëndësinë e luftës ndaj tij.

Në orën e fizikës me klasat e 8-ta

Nxënësit e klasës së 8-të zhvilluan një orë mësimore ndryshe nga herët e tjera. Ata folën rreth temës “Përhapja e tingullit në mjedise të ndryshme”. Me anë të eksperimentit që u zhvillua u transmetuan llojet e ndryshme të tingujve, mënyrat se si objektet vibronin, përhapjen e valëve, si dhe rrugën që tingulli do të ndiqte për t’u përcjellë. Çdo veprim u shoqërua me anë të praktikës.



Argëtohemi dhe mësojmë duke përdorur teknologjinë

Nxënësit e klasës së 2F zhvilluan një orë mjaft surprizuese dhe të veçantë në klasën e iPadëve. Ata punuan me testin online Kahoot, një test me alternativa dhe me pyetje kryesisht logjike. Në përfundim të testit u paraqitën emrat e 4 nxënësve që punuan më shpejt dhe më pas renditja e pjesës tjetër të klasës. Për nxënësit kjo ishte diçka e pabërë më parë dhe argëtuese.



Dramatizim i nxënësve të klasës së 2A



Klasa e 2A realizoi një orë mësimi ndryshe dhe tepër kreative. Referuar temës mësimore "Stilolapsi dhe Kompjuteri", nxënësit të ndarë në role, ndërtuan në mjediset e shkollës një skenë të vërtetë teatri. Krahas interpretimit të saktë dhe mesazhit të përcjellë, nxënësit u vlerësuan për kompozimin e personazheve dhe veshjeve të tyre të realizuara me kartona dhe lëndë ricikluese.

Puzzle me nxënësit e klasës së 3D



E veçanta e kësaj ore kishte të bënte me mënyrën se si ne mund të mësojmë dhe zbavitemi njëkohësisht.

Nxënësittreguansekjomundtëarrihet ndërmjet “Librit dhe lojës puzzle”.

Secili prej tyre kishte përgatitur kopertinën e librit të preferuar dhe të ndarë në grupe me nga 2 nxënës, duhej të formonin sa më shumë kopertina të plota libri.

Listës së librave, që duhen lexuar gjatë pushimeve, iu shtuan dhe shumë tituj të rinj.

Mirëkuptimi forcon grupin

Për ta bërë me reale temën e mësimi në lëndën e qytetarisë, në klasën e 3F u zhvillua një orë mësimi ndryshe.

Tema e orës së mësimi ishte “Mirëkuptimi forcon grupin, sepse ne na bashkojnë interesat e përbashkëta”. Objektivat kryesore ishin kuptimi i interesave të përbashkëta, si: dëshira për të mësuar, bashkëpunimi midis nxënësve, toleranca, etj. Mësimi u hap me diskutime midis nxënësve, duke u ndjekur nga zgjidhja e situatave dhe konflikteve që fëmijët mund të kenë hasur në përditshmërinë e tyre.



Flasim në “TOC Talks”

Të inkurajojmë nxënësit tanë të artikulojnë, të flasin dhe të shprehin saktë e bukur mendimet e tyre kur është e nevojshme, ka qenë dhe është një ndër qëllimet tona si shkollë. Për këtë arsye “TOC Talks” i jep mikrofonin dhe mundësinë secilit nxënës që ka diçka për të thënë, për të informuar, nxitur, apo edhe për të bërë për të qeshur, të shfaqet në formën më të mirë, duke u shprehur. Kushdo që ndien se është një folës i mirë mund të marrë pjesë. Videot e regjistruara do të publikohen në faqen e shkollës në youtube si dhe në Facebook.



Nxënësit e klasës së 1F në orën e veprimtarisë “Flamuri ynë kombëtar”



Nxënësit e klasës së 1F zhvilluan orën e Veprimtarisë me temë “Flamuri ynë kombëtar”. Materialet e përdorura për të ndërtuar flamurin ishin nga më të ndryshmet, si: fara luledielli, kartonë, lëndë ricikluese etj. Punimet e shumta krijuese përçuan mjaft mirë qëllimet e veprimtarisë të nxënësit, siç ishin njohja e nxënësve me simbolet kombëtare, bashkëveprimi midis nxënësve dhe argëtimi i tyre përmes kësaj veprimtarie edukative.

Nxënësit e klasës së 1B veprimtari “Çfarë është respekti?”



Nxënësit e klasës së 1B gjatë orës së fundit edukative për këtë vit mësuam se si t'i nderojnë njerëzit dhe si t'i trajtojnë ata me kujdes e mirësjellje. Mësuam se respekti qëndron te besimi ndaj të tjerëve, ndaj vlerave të tyre.

Kjo orë edukative u shoqërua me një sërë aktivitete, si: loja “Rrjeta e merimangës”, pema e fjalëve magjike, puna në grup, dramatizimi me role, krijimi i posterit etj

Karnavalet në klasën e 5A

Sa herë që dëgjojmë fjalën “Karnavale” ne mendojmë për Rio De Janerio dhe njerëz të veshur me veshje nga më të veçantat për nga stili dhe ngjyrat. Por këtë atmosferë feste kalendarike për qindra vite na e sollën nxënësit e klasës së 5A. Të veshur si shumë personazhe të adhuruar prej tyre dhe që do të donin t'i ngjanin, ata dukeshin mrekullisht bukur. Nxënësit kishin kënaqësi të tregonin e të flisnin për përzgjedhjet e veshjeve, duke shpalosur përpara shokëve një botë të gjerë me idhuj dhe heronj, e që u shkonte mjaft.



Aktivitete sportive

Një stërvitje futbollit me nxënësit e klasave të 4-ta dhe të 5-ta

Përfaqësues nga Akademia Juventus, një qendër e hapur së fundmi në Tiranë, e cila ofron kurse futbollit, vizituan ambientet sportive të shkollës sonë për të zhvilluar një seancë stërvitore me nxënësit e klasave të 4-ta dhe të 5-ta. Kjo stërvitje e veçantë u organizua në disa orë mësimi, në të cilat nxënësit u trajnuan dhe praktikuan teknika nga më të ndryshme të futbollit, të shpjeguara nga trajnerët e Akademisë Juventus.



Kampionati i Basketbollit për vajzat



Aktivitetet sportive janë nga më të dashurat për nxënësit e shkollës sonë. Në to gërshetohen dukshëm taktikat dhe aftësia që kanë nxënësit tanë në sporte të ndryshme, bukuria e entuziazmi i lojës, si dhe dëshira për fitore. Energji, lojë e bukur, emocione!

Kampionati që po zhvillohet përgjatë kësaj periudhe është Kampionati i Basketbollit për klasat 7-8-9-të, si për vajzat dhe për djemtë. Ndeshjet e zhvilluara kanë qenë plot emocion dhe nuk kanë munguar dhe "tifozët" e mbështetësit për çdo skuadër.

Kampionati i Basketbollit me klasat e 8-ta

Në aktivitete të tilla siç janë kampionatet, nxënësit tregojnë aftësitë e tyre sportive dhe gjithashtu kënaqen duke u ndeshur me skuadrat e klasave të tjera rivale. Për këtë vit Kampionati i Basketbollit për klasat e 8-ta u zhvillua fillimisht me djemtë. Faza eliminatorie është zhvilluar mes klasave e më pas klasat fituese janë ndeshur në gjysmëfinale, duke zgjedhur ekipet të cilat do të ndeshen në finale për kupën.



Kampionati i Basketbollit te klasat e 6-ta



Ka përfunduar Kampionati i Basketbollit për klasat e gjashta. Në finale u ndeshën ekipet e klasave 6A – 6G. Atmosfera e ndezur përreth fushës u shtoi edhe më shumë dëshirën për të luajtur bukur dy skuadrave përfaqësuese. Loja ishte e fortë dhe konkurruese. Ndeshja u finalizua me fitoren e klasës së 6G, me vetëm një kosh më tepër, në rezultatin 9 - 10 për të 6G.

SNEAKER STATE OF MIND



Dorëzoni këtë kupon në dyqanin BUZZ
në QTU dhe do të përfitoni 20% ULJE në Koleksionin e Ri Spring-Summer 2019.

20% ULJE

📍 QTU | AUTOSTRADA | TIRANË - DURRES



Buzz Sneaker Station Albania
@buzzsneakerstation

Temat e kopshtit

Mirë se vini fëmijë të dashur



Mirë se vini të dashur fëmijë mes zbulimeve, lodrave dhe urimeve të pafundme...

Kopshti "Turgut Özal" priti sërish këtë shtator vogëlushët e grupeve të para, të dyta dhe të parashkollorit. Zërat e tyre si cicërima zogjsh rikthyen gjallërinë dhe gëzimin në ambientet e shkollës.

Buzëqeshja, gëzimi, hareja dhe lodrimi si pjesë e pandarë e edukimit dhe e jetës së tyre do t'i shoqërojnë gjatë këtij viti shkollor.

Grupet e parashkollorit te Liqeni Artificial në Ditën e balonave



Fëmijët e grupeve të treta, organizuan një ekskursion te liqeni artificial, për t'u argëtuar dhe për t'i parë më nga afër ngjyrat e vjeshtës.

Fëmijët të gëzuar dhe plot kuriozitet vështronin pemët gjithandej megjethet mengjyra të ndryshme, të verdha, të kuqe e jeshile, të cilat shkriheshin dhe harmonizoheshin mjaft natyrshëm me larmishmërinë e balonave që valëviteshin rrotull tyre. U mahnitën nga llojshmëria e ngjyrave të gjetheve, por zbuluan sekretin se përse vjeshta quhet 'e artë'.

Fëmijët e parashkollorit në Muzeun Historik Kombëtar

Me rastin e Festave të Nëntorit fëmijët e vegjël të parashkollorit vizituan Muzeun Historik Kombëtar. Megjithëse të vegjël, fëmijëve iu shpjegua historia e popullit tonë me fjalë të thjeshta dhe të kuptueshme prej vogëlushëve. Në muze ata panë stendat e ndryshme të ilustruara me foto dhe objekte, të cilat përshkruanin dhe tregonin historinë e Shqipërisë. Ata me habinë e tyre feminare, nuk e fshihnin kënaqësinë dhe çudinë nga ato çka po mësonin. Për ta kjo vizitë ishte e veçantë, pasi i ndihmoi të mësonin më shumë rreth atdheut tonë, Shqipërisë.



Grupet e para në Kopshtin Botanik

Vogëlushët e grupeve të para u organizuan në një ekskursion në hapësirat e gjera e të gjelbëruara të Kopshtit Botanik. Kënaqësia e kësaj dite ishte tek peizazhi vjeshtak që natyra u ofroi, tek lojërat e shumta që bënë me njëri-tjetrin dhe çastet e gëzuara që ndanë së bashku.



Grupi “Frutat” në një orë mësimi



Grupi i parë i kopshtit “Frutat” ka menduar të zhvillojë një orë mësimore mbi rëndësinë e higjienës personale kur zgjohen nga gjumi në mëngjes. Pasi i vizatuan të gjitha mjetet që kjo higjienë i kërkon, bashkë me mësuesen praktikuan larjen e dhëmbëve e të fytyrës, fshirjen me peshqir, krehjen etj. Sigurisht që pas kësaj eksperience ku çdo veprim e bënë vetë, të vegjlit u ndjenë më të rritur e më të përgjegjshëm për pastërtinë e rregullsinë me të cilën paraqiten para të tjerëve.

Grupet e dyta me projektin "Kopshti im"

Grupet e dyta realizuan projektin me temë "Kopshti ynë". Për të përgatitur një projekt sa më bukur, ata sollën nga shtëpia disa mjete ndihmëse të tilla si guaskat apo makaronat. Pak punë e shumë imagjinatë dhe ja ku është edhe kopshti i tyre i ëndrrave, ashtu siç ata e dëshirojnë...



Fëmijët e parashkollorit mësojnë ciklin e jetës së një fluturë

Një temë e zhvilluar ditët e fundit nga mësueset e parashkollorit ishte cikli i jetës së një fluturë. Nëpërmjet informacioneve të marra nga interneti, aplikacioneve të bëra me kartona e mjete të tjera mësimore, si dhe shpjegimit të mësueseve, fëmijët kuptuan se si zhvillohet cikli jetësor i fluturave. Duke mësuar të gjitha etapat ku ai kalon, fëmijët zgjeruan dijet rreth botës që i rrethon dhe shuan kuriozitetin për këtë insekt kaq të bukur e kaq të dashur për ta.



Grupi “Zambakët” në një orë me punime të ndryshme

Fëmijët e kopshtit kanë mësuar shumë rreth botës së ngjyrave, nuancave të saj, ndarjes në ngjyra të ngrohta e të ftohta etj. Çdo ditë ata vizatojnë, ngjyrosin e bëjnë aplikacione nëpër fletat e tyre të punës. Dhe kësaj here, në një orë mësimore ata formuan ylberin me shtatë ngjyrat e tij, fluturat e bukura me krahët shumëngjyrësh dhe gjethet ngjyra-ngjyra të vjeshtës së artë. U lodhën, por edhe u argëtuan e mësuan mjaft.



Shprehim emocionet me grupin “Yjet” të parashkollorit



Të shprehësh emocionet është e vështirë për të gjithë, por jo për fëmijët e grupit “Yjet”. Në tabelën e klasës ata kanë ngjitur një pemë prej kartoni, e kanë mbushur plot me fytyra të qeshura, të mërzitura, të habitura apo të zemëruara dhe e kanë quajtur “Pema e emocioneve”. Më pas gjatë orës, fëmijët zbuluan disa sekrete të vogla rreth reagimeve që kanë me të tjerët kur ndiejnë gëzim, frikë, ndrojtje etj. Kështu ata kuptuan se kur ndjenjat i ndajnë me të tjerët trishtimi dhe pakënaqësitë përgjysmohen, ndërsa lumturia shumëfishohet.

Kujdesi për dhëmbët



“Kujdesi për dhëmbët” ka qenë tema e radhës e grupeve të parashkollorit. Së bashku me edukatoren fëmijët diskutuan në formën e një bisede për rëndësinë e higjienës së gojës në shëndetin e organizmit të tyre. Të rejtat që mësuan ishin se cilat ushqime i dëmtojnë dhëmbët dhe cilat i forcojnë ata. Gjithashtu ata prenë kartona të bardhë në formë dhëmbi dhe të tjerë me ngjyrat përkatëse të disa ushqimeve, për të cilat kishin folur gjatë kësaj ore mësimore.

Zbulo shkencën dhe teknologjinë e së ardhmes





Kolegji "Turgut Özal": Aty ku mësojnë më të minët!

